



Education and Culture DG



Korniza
Evropiane e
Kualifikimeve



Korniza evropiane e kualifikimeve (KEK) për mësimin gjatë gjithë jetës



Education
and
Training

Europe Direct është një shërbim, që u ndihmon të gjeni përgjigjet në pyetjet tuaja rreth Bashkimit Evropian

Freephone number (*):

00 800 6 7 8 9 10 11

(*) Certain mobile telephone operators do not allow Access to 00 800 numbers or these calls may be billed

More information on the European Union is available on the Internet (<http://europa.eu>).

Cataloguing data can be found at the end of this publication.

Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities, 2008

ISBN 978-92-79-08474-4

DOI 10.2766/14352

© European Communities, 2008

Reproduction is authorised provided the source is acknowledged.

Printed in Belgium

Printed on white chlorine-free Paper

KORNIZA EVROPIANE E KUALIFIKIMEVE (KEK) PËR MËSIMIN GJATË GJITHË JETËS



Lifelong Learning: Education and Training policies
Coordination of Lifelong Learning Policies

KORNIZA E KUALIFIKIMEVE PËR MËSIMIN GJATË GJITHË JETËS

KEK është një kornizë e përbashkët referuese evropiane, e cila i ndërlidh sistemet e kualifikimeve të shteteve të ndryshme evropiane dhe shërben si një mjet për t'i bërë kualifikimet më të lexueshme dhe më të kuptueshme nga vendet dhe sistemet e ndryshme evropiane. Ajo i ka dy qëllime kryesore, ta promovojë lëvizshmërinë e njerëzve ndërmjet shteteve të ndryshme dhe t'ju mundësojë të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Formalisht rekomandimi hyri në fuqi në prill të vitit 2008. Ai e cakton vitin 2010 si një datë të rekomanduar kur shtetet evropiane do t'i përshtasin sistemet e tyre kombëtare KEK-së, kurse vitin 2012 si datë kur shtetet do të sigurojnë se certifikatat e kualifikimeve individuale u referohen niveleve përkatëse të KEK-së.

KEK do t'i ndërlidhë sistemet kombëtare të kualifikimeve të shteteve të ndryshme dhe kornizat e tyre rreth një kornize të përbashkët evropiane – tetë niveleve të saj. Nivelet përfshijnë të gjitha shkallët e kualifikimeve, prej nivelit bazik (Niveli 1, p.sh. certifikata për përfundimin e arsimit të detyrueshëm) deri te niveli i avancuar (Niveli 8, p.sh. doktoratura).

Si një instrument i promovimit të të mësuarit gjatë gjithë jetës, KEK përfshin të gjitha nivelet e kualifikimeve të fituara të arsimit dhe aftësisimit të përgjithshëm, profesional dhe akademik. Përveç kësaj, korniza merret edhe me kualifikimet e fituara gjatë arsimit dhe aftësisimit fillestar dhe të vazhdueshëm. Këto tetë nivele janë të përkrahura nga aspekti i rezultateve të të mësuarit. KEK pranon se sistemet evropiane të arsimit dhe aftësisimit janë aq të ndryshme saqë për mundësimin e krahasimeve dhe bashkëpunimit ndërmjet shteteve, si bazë duhet të merren rezultatet e të mësuarit.

Rezultati i të mësuarit në KEK është i definuar si një deklaratë mbi përfundimin e një procesi të të mësuarit. Për këtë arsye KEK vë theksin në rezultatet e të mësuarit e nuk fokusohet në inpute, siç është kohëzgjatja e të mësuarit.

Rezultatet e të mësuarit janë të specifikuar në tri kategori – si njohuri, shkathtësi dhe kompetenca. Kjo sinjalizon se kualifikimet, në kombinime të ndryshme, përfshijnë një fushë të gjërë të rezultateve të të mësuarit, prej njohurive teorike, praktike dhe teknike, si dhe kompetenca shoqërore, ku është vendimtare mundësia e punës me të tjerët.

Historia e zhvillimit të KEK– prej nga erdhi KEK?

Zhvillimi i Kornizës Evropiane të Kualifikimeve filloi në vitin 2004, si përgjigje ndaj kërkesave të shteteve anëtare, partnerëve social dhe institucioneve tjera për rritje të transparencës së kualifikimeve.

Me mbështetje të një grupi të ekspertëve të KEK, komisioni përgatiti një dokument me 8 nivele të kornizës, e bazuar në rezultatet e mësimit, që kanë për qëllim të sigurojnë transparencën dhe bartshmërinë (portabilitetin) e kualifikimeve, si dhe të mbështesin të mësuarit gjatë gjithë jetës. Gjatë pjesës së dytë të vitit 2005, Komisioni e publikoi këtë dokument për diskutim publik nëpër tërë Evropën.

Nga diskutimi publik doli mbështetja e gjerë nga shtetet evropiane për propozimin e Komisionit, mirëpo gjithashtu u kërkuan disa sqarime dhe thjeshtësime. Duke reaguar ndaj këtyre kërkesave, në bazë të inpleteve të ekspertëve nga 32 shtete të përfshira, si dhe të partnerëve social evropian, Komisioni e ndryshoi këtë propozim. Me 6 shtator 2006 Komisioni e adoptoi tekstin e ndryshuar, si propozim të ri. Gjatë vitit 2007 Parlamenti dhe Këshilli Evropian zhvilluan negociatën të suksesshme, të cilat çuan në adoptimin formal të KEK në shkurt 2008.



Cilat janë përfitimet e Evropës nga KEK?

Ky dokument (rekomandim) vendos një pikë të përbashkët referuese evropiane, që do t'i lidhë sistemet e ndryshme kombëtare të kualifikimeve dhe do të sigurojë komunikim më të mirë ndërmjet tyre. Kështu do të krijohet një rrjet i sistemeve të kualifikimeve të pavarura, por të lidhura dhe të kuptueshme në mes veti.

Duke i përdorë rezultatet e mësimit, si pika të përbashkëta referuese, korniza do të sigurojë krahasim dhe transferim të kualifikimeve ndërmjet shteteve, sistemeve dhe institucioneve, prandaj do të jetë relevante për një rreth të gjerë të përdoruesve në nivele kombëtare dhe në atë evropiane.

Shumica e shteteve evropiane kanë vendosur t'i zhvillojnë kornizat kombëtare të kualifikimeve duke u bazuar në KEK. Këto zhvillime janë të rëndësishme për sigurimin se proceset e bashkëpunimit evropian janë të ankoruara si duhet në nivelet kombëtare. Zhvillimi i shpejtë i kornizave kombëtare pas vitit 2004 demonstroi nevojën për transparencë të rritur dhe krahasueshmërinë e kualifikimeve në çdo nivel dhe tregoi se principet bazike të KEK janë gjerësisht të pranishme.

Ky raport më i afërt ndërmjet sistemeve kombëtare të kualifikimeve do të ketë shumë përfitues:

- KEK do të mbështes mobilitetin më të madh të nxënësve dhe të punëtorëve.
Për nxënësit/kandidatët që dëshirojnë të kalojnë në shtete tjera do të jetë si lehtësi përshkrimi i nivelit të gjerë të kompetencave të tyre. Kjo do t'u ndihmojë edhe punëdhënësve që t'i kuptojnë kualifikimet e aplikantëve dhe kështu të mbështetet mobiliteti i tregut të punës në Evropë.
Nga aspekti praktik, prej vitit 2012 të gjitha kualifikimet e reja duhet t'i referohen një niveli të duhur të KEK-së. Në këtë mënyrë, KEK do t'i plotësojë dhe fuqizojë instrumentet ekzistuese evropiane të mobilitetit, siç janë Europass, Erasmus dhe ECTS.
- KEK paraqet dobi për individ nëpërmjet qasjes dhe pjesëmarrjes së rritur në të mësuarit gjatë gjithë jetës. Me vendosjen e një pike të përbashkët referuese, KEK do të udhëzojë si mund të kombinohen rezultatet e mësimit në nivele të ndryshme, p.sh. në arsimin formal, ose në punë, në shtete të ndryshme dhe kështu mund të kontribuojë në zvogëlimin e barrierave ndërmjet institucioneve arsimore dhe të aftësimin profesional, p.sh. ndërmjet arsimit të lartë dhe arsimit të aftësimin profesional, të cilat mund të veprojnë si të izoluar në mes veti. Kjo do ta promovojë progresin, ashtu që nxënësit nuk kanë nevojë t'i përsërisin mësimit.
- KEK mund t'i mbështesë individët me përvojë ekstensive në punë, ose fusha tjera duke mundësuar vlefshmërinë e të mësuarit joformal dhe informal. Fokusimi në rezultatet e të mësuarit do ta bëjë më të lehtë vlerësimin se a janë rezultatet e fituara në këto institucione ekuivalente në përmbajtje dhe rëndësi me kualifikimet formale.
- KEK do t'i mbështes individët dhe ofruesit e arsimit dhe aftësimin, duke rritur transparencën e kualifikimeve të dhëna jashtë sistemeve kombëtare, p.sh. nga sektorët dhe kompanitë multinationale. Përvetësimi i një kornize të përbashkët referuese, të bazuar në rezultatet e të mësuarit do ta mundësojë krahasimin dhe ndërlidhjen e kualifikimeve tradicionale, të dhëna nga autoritetet kombëtare dhe nga partnerët tjerë. Në këtë mënyrë KEK do t'u ndihmojë sektorëve të ndryshëm dhe individëve t'i shfrytëzojnë përparësitë e ndërkombëtarizimit të rritur të kualifikimeve.
KEK është një instrument ambicioz dhe me ndikim të gjerë, që ka implikime për sistemet e arsimit dhe aftësimin, tregun e punës, ekonominë dhe qytetarët.

Më tepër informata mund të gjinden në:

http://ec.europa.eu/dgs/education_culture/index_en.html

REKOMANDIMI I PARLAMENTIT DHE KËSHILLIT EVROPIAN

të 23 prill 2008

për zhvillimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për mësimin gjatë gjithë jetës

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN

Duke pasur parasysh Traktatin, që themelon Komunitetin Evropian dhe në veçanti Nenin 149(4) dhe Nenin 150(4),

Duke pasur parasysh propozimin prej Komisionit,

Duke pasur parasysh tezën e Komitetit Ekonomik dhe Shoqëror Evropian ¹,

Duke pasur parasysh tezën e Komitetit të Rajoneve ²,

Duke pasur parasysh procedurën e dhënë në Neni 251 të Traktatit³,

¹ OJ C 175, 27.7.2007, p. 74.

² OJ C 146, 30.6.2007, p. 77.

³ Opinion of the European Parliament of 24 October 2007 (not yet published in the Official Journal) and Council Decision of 14 February 2008.



Ku,

(1) Zhvillimi dhe njohja e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave të qytetarëve janë vendimtare për zhvillimin e individëve, konkurrencës, punësimit dhe kohezionit social në Komunitet. Zhvillimi dhe njohja e tillë do të mundësojnë mobilitet ndërkombëtar për punëtorët dhe nxënësit dhe do të kontribuojnë në plotësimin e kërkesave të tregut evropian të punës. Hyrja dhe pjesëmarrja në të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë, përfshirë edhe njerëzit me të meta dhe përdorimi i kualifikimeve duhet të promovohet dhe të përmirësohet, si në nivelin kombëtar, ashtu edhe në atë të Komunitetit.

(2) Këshilli Evropian i Lisbonës në vitin 2000 erdhi në përfundim se transparenca e rritur e kualifikimeve duhet të jetë një prej komponenteve kryesore të nevojshme për adaptimin e sistemeve të arsimit dhe aftësimin në Komunitet ndaj kërkesave të shoqërisë së njohurive. Gjithashtu, edhe Këshilli Evropian i Barcelonës nga viti 2002 ftoi për një bashkëpunim më të ngushtë në sektorin universitar dhe për përmirësim të transparencës dhe metodave të njohjes në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional.

(3) Rezoluta e Këshillit mbi të mësuarit gjatë gjithë jetës nga 27 qershori 2002 e ftoi Komisionin, në bashkëpunim të ngushtë me Këshillim dhe shtetet anëtare, ta zhvillojë një kornizë për njohjen e kualifikimeve të arsimit dhe aftësimin, në bazë të të arriturave të procesit të Bolonjës dhe të promovojë veprim të ngjashëm në fushën e aftësimin profesional.

(4) Raportet e përbashkëta të Këshillit dhe të Komisionit rreth implementimit të programit të punës "Arsimi dhe Aftësimi 2010", të adoptuar më 2004 dhe 2006, e shtruan nevojën e zhvillimit të një Kornize Evropiane të Kualifikimeve.

(5) Në kontekst të procesit të Kopenhagës, konkluzionet e Këshillit dhe të përfaqësuesve të qeverive të shteteve anëtare, gjatë takimit në Këshill me 15 nëntor 2004 rreth prioriteteve të ardhshme të bashkëpunimit të rritur evropian në arsimin dhe aftësimin profesional, i dhanë prioritet zhvillimit të një kornize të hapur dhe fleksibile të kualifikimeve, të bazuar në transparençë dhe besim të dyanshëm, që duhet të jetë si një referencë e përbashkët që e mbulon arsimin dhe aftësimin.

(6) Vlefshmëria e rezultateve të të mësuarit joformal dhe informal duhet të promovohet në pajtim me konkluzionet e Këshillit rreth principeve të përbashkëta evropiane për identifikimin dhe vlefshmërinë e të mësuarit joformal dhe informal nga 28 maji 2004.

(7) Këshilli evropian i Brukselit nga marsi i vitit 2005 dhe marsi 2006 e theksuan rëndësinë e adoptimit të një Kornize Evropiane të Kualifikimeve.

(8) Ky rekomandim merr parasysh vendimin nr. 2241/2004/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit nga 15 dhjetori 2004 për një kornizë të vetme të Komunitetit për transparençë të kualifikimeve dhe të kompetencave (Europass) dhe Rekomandimin 2006/962/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 18 dhjetor 2006 rreth kompetencave kyçe për të mësuarit gjatë gjithë jetës.

(9) Ky rekomandim është në pajtueshmëri me Kornizën e Arsimit të Lartë Evropian dhe përshkruarit ciklik, të vendosur nga ministrat përgjegjës për arsimin e lartë në 45 shtete evropiane, gjatë takimit të tyre në Bergen më 19 dhe 20 maj 2005, në kuadër të kornizës së procesit të Bolonjës.

(10) Konkluzionet e Këshillit mbi sigurimin e cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional të 23 dhe 24 majit 2004, rekomandimi 2006/143/EC i Parlament Evropian dhe Këshillit të datës 15 shkurt 2006 rreth

bashkëpunimit të mëtejshëm evropian në sigurimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe standardet e udhëzimit për sigurimin e cilësisë në Arsimin e Lartë Evropian, të vendosura nga ministrat përgjegjës për arsimin e lartë në takimin e Bergenit, përmbajnë principe të përbashkëta për sigurimin e cilësisë, që do të mbështesin implementimin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.

(11) Ky rekomandim nuk ka paragjykime ndaj direktivës 2005/36/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 7 shtator 2005 rreth njohjes së kualifikimeve profesionale, që i përcjellë të drejtat dhe obligimet autoritetit relevant kombëtar, si dhe migruesit. Referimi në nivelet e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve nuk duhet të ndikojë në hyrjen në tregun e punës, ku kualifikimet profesionale janë të njohura në pajtim me direktivën 2005/36/EC.

(12) Qëllimi i këtij rekomandimi është krijimi i një kornize të përbashkët referuese, e cila duhet të shërbejë si një mjet përkthimi ndërmjet sistemeve të ndryshme të kualifikimeve dhe nivele të tyre, si për arsimin e përgjithshëm, atë të lartë, ashtu edhe për arsimin dhe aftësimin profesional. Kjo do ta përmirësojë transparencën, krahasueshmërinë dhe portabilitetin e kualifikimeve, të dhëna në pajtim me praktikën e ndryshme të shteteve anëtare. Në princip, secili nivel i kualifikimeve mund të arrihet me rrugë të ndryshme të arsimimit dhe zhvillimit të karrierës. Korniza Evropiane e Kualifikimeve duhet të mundësojë që organizatat sektoriale ndërkombëtare t'i ndërlihdin sistemet e tyre të kualifikimeve me një pikë të përbashkët referuese evropiane dhe ta tregojnë raportin në mes të kualifikimeve ndërkombëtare sektoriale dhe sistemeve të kualifikimeve kombëtare. Për këtë arsye, ky rekomandim kontribuon në objektivat më të gjëra të promovimit të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe të rritjes së punësueshmërisë, mobilitetin dhe integritet social të punëtorëve dhe nxënësve. Principet transparente të sigurimit të cilësisë dhe këmbimi i informatave do ta mbështesin implementimin e saj, duke ndihmuar ndërtimin e besimit reciprok.

(13) Ky rekomandim duhet të kontribuojë në modernizimin e sistemeve të arsimit dhe aftësimin, në raportet e brendshme në mes të arsimit, aftësimin dhe punësimin dhe ndërtimin e urave në mes të të mësuarit formal, joformal dhe informal, duke çuar edhe në vlefshmërinë e rezultateve të të mësuarit të fituara me përvojë përkatëse.

(14) Ky rekomandim nuk i zëvendëson, e as nuk i definojnë sistemet kombëtare të kualifikimeve dhe/ose kualifikimet. Korniza Evropiane e Kualifikimeve nuk i përshkruan kualifikimet specifike, apo kompetencat individuale. Kualifikimet e caktuara duhet t'i referohen nivelit përkatës të kornizës, sipas mënyrës së caktuar të sistemit relevant kombëtar të kualifikimeve.

(15) Nga natyra e tij jo i detyrueshëm, ky rekomandim i përmbahet principit të mbështetjes së aktiviteteve të shteteve anëtare, duke mundësuar bashkëpunimin më të madh në mes tyre, për ta rritur transparencën dhe për ta promovuar mobilitetin dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Kjo duhet të zbatohet në pajtim me legjislacionet dhe praktikën kombëtare.

(16) Pasi që objektivi i këtij rekomandimi (krijimi i një kornize të përbashkët referuese, që do të shërbejë si një mjet përkthimi ndërmjet sistemeve të ndryshme të kualifikimeve dhe niveleve të tyre) nuk mund të arrihet plotësisht nga shtetet anëtare dhe për shkak të shkallëve dhe efekteve të aksioneve të parapara, më lehtë mund të arrihet në nivelin e Komunitetit, Komuniteti mund të adoptojë masa, në pajtim me principin e subvencionimit, si është paraparë në nenin 5 të marrëveshjes. Në pajtim me principin e proporcionalitetit, si parashihet në nenin e mësipërm, ky rekomandim nuk shkon përtej asaj çfarë është e nevojshme, për ta arritur objektivin e lartëpërmendur,

NË KËTË MËNYRË REKOMANDOJMË QË SHTETET ANËTARE:

1. ta përdorin Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, si një mjet referues për krahasimin e niveleve të kualifikimeve të sistemeve të ndryshme të kualifikimeve, promovimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, mundësive të barabarta në një shoqëri të bazuar në njohuri, si dhe integrimin e mëtejshëm të tregut evropian të punës, duke respektuar diversitetin e pasur të sistemeve arsimore kombëtare;
2. t'i ndërlidhin sistemet e tyre kombëtare të kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve deri në vitin 2010, posaçërisht duke i referuar, në mënyrë transparente, nivelet e tyre të kualifikimeve niveleve të përcaktuara në Aneksin II dhe aty ku është e përshtatshme, duke i zhvilluar Kornizat Kombëtare të Kualifikimeve në pajtim me legjislacionin dhe praktikën kombëtare;
3. të përvetësojnë masa adekuate, ashtu që deri në vitin 2012 të gjitha certifikatat, diplomatat dhe dokumentet e Europass-it, të lëshuara nga autoritetet kompetente përmbajnë një referencë të qartë nga sistemet kombëtare të kualifikimeve në nivelin gjegjësisht të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve;
4. gjatë definimit dhe përshkrimit të kualifikimeve, të përdorin një qasje të bazuar në rezultatet e të mësuarit dhe të promovojnë vlefshmërinë e të mësuarit joformal dhe informal në pajtim me principet e përbashkëta evropiane, të vendosura në konkluzionet e Këshillit të datës 28.05.2004, duke i kushtuar vëmendje të posaçme qytetarëve, që mund të jenë të papunësuar, ose me punësim të pasigurt dhe të cilëve një qasje e tillë mund t'u ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes në të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe akses më të lehtë në tregun e punës;
5. t'i promovojnë dhe aplikojnë principet e sigurimit të cilësisë në arsim dhe aftësim, të përcaktuara në Aneksin III, gjatë referimit të kualifikimeve të arsimit të lartë dhe arsimit e aftësimin profesional brenda sistemeve kombëtare të kualifikimeve në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve;
6. t'i përcaktojnë pikat kombëtare të koordinimit, të lidhura për struktura dhe kërkesa të posaçme të shteteve anëtare, në mënyrë që t'i mbështesin dhe në bashkëveprim me autoritetet tjera relevante kombëtare, t'i udhëheqin raportet ndërmjet sistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, me qëllim të promovimit të cilësisë dhe transparencës së këtyre raporteve.

Detyrat e këtyre pikave kombëtare të koordinimit duhet të përfshijnë:

- (a) nivelet referuese të kualifikimeve brenda sistemeve kombëtare të kualifikimeve ndaj niveleve të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të përshkruara në Aneksin II;
- (b) sigurimin se është përdorë një metodologji transparente për referimin e niveleve kombëtare të kualifikimeve ndaj Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, në mënyrë që të mundësohet krahasimi në mes tyre në njërin anë dhe në anën tjetër për t'u siguruar se vendimet rezultuese janë publikuar;
- (c) ofrimin e qasjes në informata dhe udhëzimin e partnerëve rreth asaj se si ndërlidhen kualifikimet kombëtare me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve nëpërmjet sistemeve të kualifikimeve kombëtare;
- (d) promovimin e pjesëmarrjes së të gjithë partnerëve relevantë, duke përfshirë, në pajtim me legjislacionin dhe praktikën kombëtare, arsimin e lartë dhe institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional, partnerët social, sektorët dhe ekspertët e krahasimit dhe të përdorimit të kualifikimeve në nivelin evropian.

MIRATOJ QËLLIMIN E KOMISIONIT PËR:

1. mbështetjen e shteteve anëtare në kryerjen e detyrave të mësipërme dhe të organizatave sektoriale ndërkombëtare në përdorimin e niveleve të referencës dhe të principeve të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, ashtu si është cekë në këtë rekomandim, në veçanti duke mundësuar bashkëpunimin, këmbimin e praktikave të mira dhe testimin, ndër të tjera nëpërmjet rishikimit vullnetar dhe projekteve pilot të programeve të Komunitetit, duke lansuar ushtrime informative dhe konsultuese me komitete të dialogut social dhe duke zhvilluar materiale mbështetëse dhe udhëzuese;
2. themelimin e një grupi këshillëdhënës të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, deri më 23.04.2009, të përbërë nga përfaqësuesit e shteteve anëtare dhe duke përfshirë partnerët social evropian dhe të tjerë, që janë përgjegjës për mundësimin e koherencës dhe promovimin e transparencës së procesit të referimit të kualifikimeve ndaj Kornizës Evropiane të Kualifikimeve;
3. në bashkëpunim me shtetet anëtare dhe pas konsultimit me partnerët e interesuar, vlerëso veprimin e ndërmarrë, si përgjigje ndaj këtij rekomandimi, duke përfshirë kohëzgjatjen e grupit këshillëdhënës dhe deri më 23.04.2013 raporto në Parlamentin dhe Këshillin Evropian rreth përvojës së fituar dhe implikimeve për të ardhmen, përfshirë edhe rishikimin dhe revidimin e mundshëm të rekomandimit, nëse ka nevojë;
4. promovimin e lidhjeve të ngushta në mes të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve dhe sistemeve ekzistuese ose të ardhshme evropiane të transferit dhe akumulimit të kredive në arsimin e lartë dhe arsimin e aftësimin profesional, në mënyrë që të përmirësohet mobiliteti i qytetarëve dhe të mundësohet njohja e rezultateve të të mësuarit.

Strasbourg, 23 prill 2008.

Për Parlamentin Evropian
Kryetari
HANS-GERT PÖTTERING

Për Këshillin
Kryetari
JANEZ LENARČIČ

ANEKSI 1

Përkufizimet

Përkufizimet që përdoren në këtë rekomandim janë dhënë më poshtë:

(a) "kualifikim" do të thotë një rezultat formal i një procesi të vlerësimit dhe vlefshmërisë, i cili fitohet kur një institucion kompetent përcakton se një individ i ka arritur rezultatet e të mësuarit me standarde të duhura;

(b) "sistemi kombëtar i kualifikimeve" nënkupton të gjitha aspektet e aktiviteteve të shtetit anëtar, të lidhura me njohjen e të mësuarit dhe mekanizmat tjerë, që e lidhin arsimin dhe aftësimin me tregun e punës dhe shoqërinë civile. Këtu përfshihet zhvillimi dhe implementimi i aranzhimeve dhe proceseve institucionale të lidhura me sigurimin e cilësisë, vlerësimin dhe dhënien e kualifikimeve.

Një sistem kombëtar i kualifikimeve mund të përbëhet nga disa nënsisteme dhe mund të përfshijë kornizën kombëtare të kualifikimeve;

(c) "korniza kombëtare e kualifikimeve" është një instrument për klasifikimin e kualifikimeve në bazë të një grumbulli të kritereve për nivelet e specifikuara të të mësuarit të arritur, që ka për qëllim integrimin dhe koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve dhe përmirësimin e transparencës, aksesit, progresit dhe cilësisë së kualifikimeve në raport me tregun e punës dhe shoqërinë civile;

(d) "sektor" do të thotë një grupim i aktiviteteve profesionale, në bazë të funksionit të tyre kryesor ekonomik, produktit, shërbimit, ose teknologjisë;

(e) "organizatë ndërkombëtare sektoriale" nënkupton një shoqatë të organizatave kombëtare, që përfshin psh. punëdhënësit dhe institucionet profesionale, të cilat përfaqësojnë interesat e sektorëve kombëtar;

(f) "rezultatet e të mësuarit" janë deklaratat për atëçka dinë nxënësit, kuptojnë dhe janë në gjendje të bëjnë pas përfundimit të një procesi të të mësuarit, të cilat janë të definuara nga aspekti i njohurive, shkathtësive dhe kompetencave;

(g) "njohuri" do të thotë rezultat i absorbimit të informatave nëpërmjet të mësuarit.

Njohuritë janë një grumbull të dhënash, principesh, teorish dhe praktikash të ndërlidhura me një fushë të punës, ose të studimit. Në kontekstin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, njohuritë janë të përshkruara si teorike dhe/ose praktike;

(h) "shkathtësitë" nënkuptojnë aftësinë për aplikimin e njohurive dhe përdorimin e teknikave për përfundimin e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve. Në kontekstin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, shkathtësitë janë të përshkruara si kognitive (përfshijnë përdorimin e të menduarit logjik, intuitiv dhe kreativ) ose praktike (përfshin shkathtësitë manuale dhe përdorimin e metodave, materialeve, veglave dhe instrumenteve);

(i) "kompetencë" do të thotë aftësi e vërtetuar e përdorimit të njohurive, shkathtësive dhe aftësive personale, sociale dhe/ose metodologjike, në punë, ose në studime dhe në zhvillimin profesional dhe personal. Në kontekstin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, kompetenca është e përshkruar në aspekt të përgjegjësisë dhe autonomisë.

ANEKSI II

Përshkruesit, që përkufizojnë nivelet në Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK)

| | | Njohuritë |
|--------------|---|---|
| | | Në kontekstin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, njohuritë janë të përshkruara si teorike dhe/ose praktike. |
| Niveli 1 | Rezultatet e mësimit, relevante për nivelin 1 | <ul style="list-style-type: none"> • njohuri të përgjithshme bazë |
| Niveli 2 | Rezultatet e mësimit relevante për nivelin 2 | <ul style="list-style-type: none"> • njohuri të bazuara në fakte në një fushë të punës ose studimit |
| Niveli 3 | Rezultatet e mësimit relevante për nivelin 3 | <ul style="list-style-type: none"> • njohuri të fakteve, parimeve, proceseve dhe koncepteve të përgjithshme në një fushë të punës ose studimit |
| Niveli 4 | Rezultatet e mësimit relevante për nivelin 4 | <ul style="list-style-type: none"> • njohuri teorike dhe të bazuar në fakte në kontekste të gjëra brenda një fushe të punës ose studimit |
| Niveli 5* | Rezultatet e mësimit relevante për nivelin 5 | <ul style="list-style-type: none"> • njohuri teorike dhe faktike , gjithëpërfshirëse, brenda një fushe të specializuar të punës ose studimit dhe një ndërgjegjësim për kufijtë e bazës së njohurive |
| Niveli 6** | Rezultatet e mësimit relevante për nivelin 6 | <ul style="list-style-type: none"> • njohuri të avancuara në një fushë të punës ose studimit duke përfshirë një të kuptuar kritik të teorive dhe parimeve |
| Niveli 7*** | Rezultatet e mësimit relevante për nivelin 7 | <ul style="list-style-type: none"> • njohuri të specializuara të nivelit të lartë, një pjesë e të cilave janë pjesë thelbësore e njohurive të një fushe të punës dhe studimit, si bazë për të menduarit origjinal • vetëdijesim kritik ndaj çështjeve të njohurive të një fushe dhe ndaj lidhshmërisë midis fushave të ndryshme |
| Niveli 8**** | Rezultatet e mësimit relevante për nivelin 8 | <ul style="list-style-type: none"> • njohuri në kufijtë më të avancuar të një fushe të punës ose studimit dhe për lidhshmëritë midis fushave të ndryshme |

Secili prej 8 niveleve është i përkufizuar nga një grup i përshkruesve, që japin rezultatet e mësimit, relevante për kualifikimet në atë nivel, në çfarëdo sistemi të kualifikimeve.

| Shkathtësitë | Kompetencat |
|---|---|
| Në kontekstin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, shkathtësitë janë të përshkruara si kognitive (përfshijnë përdorimin e të menduarit logjik, intuitiv dhe kreativ) ose praktike (përfshin shkathtësitë manuale dhe përdorimin e metodave, materialeve, veglave dhe instrumenteve); | Në kontekstin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, kompetenca është e përshkruar në aspekt të përgjegjësisë dhe autonomisë. |
| <ul style="list-style-type: none"> shkathtësi bazë, të nevojshme për kryerjen e detyrave të thjeshta | <ul style="list-style-type: none"> kompetencë për të punuar dhe studiuar nën mbikëqyrje të drejtpërdrejt në një kontekst të strukturuar |
| <ul style="list-style-type: none"> shkathtësi bazë teorike dhe praktike, të nevojshme për përdorimin e informatave relevante, për të kryer detyra dhe për të zgjidhur probleme të zakonshme, duke përdor rregulla dhe vegla të thjeshta | <ul style="list-style-type: none"> kompetencë për të punuar dhe studiuar nën mbikëqyrje, me pak autonomi, në kontekste të thjeshta dhe të qëndrueshme |
| <ul style="list-style-type: none"> një radhë shkathtësish teorike dhe praktike, të nevojshme për kryerjen e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve, duke përzgjedhur dhe përdor metoda, mjete, materiale dhe informacione | <ul style="list-style-type: none"> zotësi për të marrë përsipër përgjegjësinë për kryerjen e detyrave në kontekste të qëndrueshme të punës ose studimit zotësi për të përshtatur sjelljen ndaj rrethanave në zgjidhjen e problemeve |
| <ul style="list-style-type: none"> një radhë e shkathtësive teorike dhe praktike, të nevojshme për gjetjen e zgjidhjeve për problemet e veçanta të një fushe të punës ose studimit. | <ul style="list-style-type: none"> kompetencë në vetmenaxhim brenda direktivave të kontekstit të punës ose studimit, që janë zakonisht të parashikueshme, por të prirura për të ndryshuar kompetencë për të mbikëqyrur punën rutinore të tjerëve, për të marrë përsipër njëfarë përgjegjësie për vlerësimin dhe përmirësimin e aktiviteteve të punës ose studimit |
| <ul style="list-style-type: none"> një radhë gjithëpërfshirëse e shkathtësive teorike dhe praktike, të nevojshme për gjetjen e zgjidhjeve kreative ndaj problemeve abstrakte | <ul style="list-style-type: none"> kompetencë në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të punës ose studimit në kontekstet ku ka ndryshime të paparashikueshme zotësi për të rishikuar dhe zhvilluar performancën vetjake dhe të tjerëve |
| <ul style="list-style-type: none"> shkathtësi të avancuara, duke demonstruar mjeshtëri dhe risi në zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikuara në një fushë të specializuar të punës dhe studimit | <ul style="list-style-type: none"> kompetencë në menaxhimin e projekteve ose aktiviteteve komplekse, teknike ose profesionale, duke marrë përsipër përgjegjësinë për marrjen e vendimeve në kontekstet e paparashikueshme të punës ose studimit kompetencë për të marrë përsipër përgjegjësi për menaxhimin e zhvillimit profesional të individëve dhe grupeve |
| <ul style="list-style-type: none"> shkathtësi të specializuara për zgjidhjen e problemeve, të nevojshme gjatë hulumtimit dhe inovacioneve, për të zhvilluar njohuri dhe procedura të reja dhe për të integruar njohuri prej fushave të ndryshme | <ul style="list-style-type: none"> Menaxhimi dhe transformimi i konteksteve të punës ose studimit, që janë komplekse, të paparashikueshme dhe kërkojnë qasje të reja strategjike Marrja e përgjegjësive për të kontribuar në njohuritë dhe praktikatat profesionale dhe/ose për rishikimin e realizimit strategjik të ekipeve |
| <ul style="list-style-type: none"> shkathtësitë dhe teknikat më të avancuara dhe të specializuara, përfshirë sintezat dhe vlerësimet, të nevojshme për zgjidhjeve e problemeve kritike, gjatë hulumtimeve ose inovacioneve, si dhe për zgjerimin dhe ridefinimin e njohurive ose praktikës profesionale ekzistuese | <ul style="list-style-type: none"> demonstrimi i autoritetit, inovacioneve, autonomisë thelbësore dhe integritetit profesional si dhe përkushtim të vazhdueshëm në zhvillimin e ideve ose proceseve të reja për pjesën më të avancuar të konteksteve të punës dhe studimit, përfshirë hulumtimin |

Pajtueshmëria me Kornizën e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë Evropian

Korniza e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë Evropian ofron përshkrues për cikle. Secili përshkrues i ciklit ofron një deklaratë bazë të pritjeve tipike të arritjeve dhe aftësive të lidhura për kualifikimet gjegjëse, të cilat paraqesin fundin e atij cikli.

* Përshkruesi i ciklit të shkurtë të arsimit të lartë (në kuadër të ciklit të parë), i zhvilluar nga Inisiativa e Cilësisë së Përbashkët, si pjesë e procesit të Bolonjës, korrespondon me rezultatet e të mësuarit të nivelit 5 të KEK-së.

** Përshkruesi i ciklit të parë në Kornizën e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë Evropian, të vendosur në takimin e ministrave përgjegjës për arsimin e lartë në Bergen, në maj të vitit 2005, në kornizën e procesit të Bolonjës u korrespondon rezultateve të të mësuarit nga niveli 6 i KEK-së.

*** Përshkruesi i ciklit të dytë në Kornizën e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë Evropian, të vendosur në takimin e ministrave përgjegjës për arsimin e lartë në Bergen, në maj të vitit 2005, në kornizën e procesit të Bolonjës u korrespondon rezultateve të të mësuarit nga niveli 7 i KEK-së.

**** Përshkruesi i ciklit të tretë në Kornizën e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë Evropian, të vendosur në takimin e ministrave përgjegjës për arsimin e lartë në Bergen, në maj të vitit 2005, në kornizën e procesit të Bolonjës u korrespondon rezultateve të të mësuarit nga niveli 8 i KEK-së.

ANEKSI III

Principet e përbashkëta për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe arsimin dhe aftësimin profesional në kontekstin e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve

Gjatë implementimit të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, sigurimi i cilësisë – që është i nevojshëm për sigurim të besueshmërisë dhe të përmirësimit të arsimit të lartë dhe arsimit e aftësimin profesional – duhet të bëhet në pajtim me principet e mëposhtme:

- Politikat dhe procedurat e sigurimit të cilësisë duhet t'i mbulojnë të gjitha nivelet e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.
- Sigurimi i cilësisë duhet të jetë pjesë integrale e menaxhimit të brendshëm të institucioneve të arsimit dhe aftësimin profesional.
- Sigurimi i cilësisë duhet të përfshijë vlerësimin e rregullt të institucioneve, programeve të tyre, ose të sistemeve të tyre të sigurimit të cilësisë, nëpërmjet agjencive ose institucioneve tjera për monitorim të jashtëm.
- Agjencitë ose institucionet tjera për monitorim të jashtëm, që kryejnë sigurimin e cilësisë duhet t'i nënshtrohen rishikimeve të rregullta.
- Sigurimi i cilësisë duhet të përfshijë dimensionet e kontekstit, inputit, procesit dhe rezultatit, duke e vënë theksin në rezultatet e të mësuarit.
- Sistemet e sigurimit të cilësisë duhet t'i përfshijnë elementet e mëposhtme:
 - objektiva dhe standarde të qarta e të matshme;
 - udhëzimet për implementim, përfshirë edhe kyqjen e partnerëve;
 - burimet adekuate;
 - metoda të pajtueshme të vlerësimit, që përfshijnë vetëvlerësimin dhe rishikimin e jashtëm;
 - mekanizma të informatës kthyesë (ang. feedback) dhe procedurat për përmirësim;
 - rezultate të vlerësimit me qasje të gjerë.
- Iniciativat e sigurimit të cilësisë në nivelin ndërkombëtar, kombëtar dhe regjional duhet të jenë të koordinuara, në mënyrë që të sigurohet kontrolli, koherenca, sinergjia dhe analizat sistemore.
- Sigurimi i cilësisë duhet të jetë një proces i bashkëpunimit nëpër të gjitha nivelet e sistemeve të arsimit dhe aftësimin, duke përfshirë të gjithë partnerët relevant, brenda shteteve anëtare dhe përgjatë tërë Komunitetit.
- Orientimet në sigurimin e cilësisë në nivelin e Komunitetit mund të ofrojnë pika të referimit për vlerësime dhe të mësuarit.

European Commission
The European Qualifications Framework for Lifelong Learning (KEK)
Luxembourg: Office for Official Publications of the European Communities

2008 — 15 pp. — 21 X 29,7 cm

ISBN 978-92-79-08474-4

HOW TO OBTAIN EU PUBLICATIONS

Our priced publications are available from EU Bookshop (<http://bookshop.europa.eu>), where you can place an order with the sales agent of your choice. The Publications Office has a worldwide network of sales agents.



Publications Office

Publications.europa.eu

ISBN 978-92-79-08474-4

